V E N D I M
Nr.95, datë 18.2.1999

PËR ANULLIMIN E SHPRONËSIMIT TË DISA PRONARËVE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I AEROPORTIT TË RINASIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.768, datë 11.11.1996, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.548,datë 27.11.1997,shpronësimi për interes publik i pasurive, që preken nga rikonstruksioni i Aeroportit të Rinasit, të pronarëve të përmendur, në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, shfuqizohet.

2. Nga shuma prej 5 716 000(pesë milionë e shtatëqindegjashtëmbëdhjetë mijë) USD, e caktuar për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga rikonstruksioni i Aeroportit të Rinasit, të zbritet shuma prej 200 058 (dyqind mijë e pesëdhjetëtetë) USD, që i përket vlerës së shpronësimit të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3.Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LISTA E PERSONAVE PËR TË CILËT ANULLOHET SHPRONËSIMI

1. Liman Lila	me	7461m2 x 6 USD= 44. 766 USD
2. Sabri Lila	me	11605 m2 x 6 USD= 69.630 USD
3. Shaban Lila	me	7491m2 x 6 USD= 44.946 USD
4. Islam Lila	me	6786 m2 x 6 USD= 40.716 USD
Totali :		33.343 m2 x 6 USD = 200.058 USD